

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dita e 109-të e protestës kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh: Nesër protestë para Parlamentit
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/dita-e-109-te-e-protestes-kunder-rames-qytetaret-rikthehen-n-e-shesh-p-i514506
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:48:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:31:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f0f0f24e99ef4cbe4bb17aef1c3c37a73033270f22f850554f3c3d20c6d9848f3
TEKSTI	45ff3e026240d0f314f73ccde8a5c911c2d404002e42c5331be3ef429b2643c9
PAMJA	582754b02cadaa4b85300f9b9dfa3caef11f6b21573b38c23aa194b7f7e6fbf3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	57fd470d785f50a78470d4f071b8763caafef7c29302c8bccd4cc608e142d4eb
E MËPARSHMJA	22321ae444a47a2f4a28feda4238ad57530338a1b6c3b189718e72e5f1935b8c
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/57fd470d785f50a78470d4f071b8763caafef7c29302c8bccd4cc608e142d4eb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

4 ORE ME PARE

Dita e 109-të e protestës kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh: Nesër protestë para Parlamentit

11 ORE ME PARE

Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë

15 ORE ME PARE

Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi

1 DITË ME PARE

SYTË NGA HAGA/ Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së, rrugët mbushen me flamuj e mbishkrime për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin: Shpallini të pafajshëm (PAMJET)

LIVE UPDATES

Dita e 109-të e protestës kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh: Nesër protestë para Parlamentit

• Protestuesit janë mbledhur sot në protestën e 109-të radhazi për largimin e Kryeministrit Edi Rama. • Fillimisht qytetarët janë mbledhur në Sheshin "Skënderbej" dhe më pas kanë marshuar drejt kryeministrit. • Pas fjalimeve të mbajtura para godinës së qeverisë, protestuesit rinisën marshimin në rrugët e kryeqytetit, duke shoqëruar lëvizjen me thirrje dhe slogane kundër qeverisë. Një pjesë e fjalimeve iu kushtua edhe vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Protestuesit shprehën solidaritetin e tyre dhe gjatë tubimit u dëgjuan edhe thirrjet "UÇK, UÇK". Protestuesit u kanë bërë thirrje qytetarëve që të mblidhen nesër në orën 10:00 para Parlamentit, në kohën kur Kuvendi do të zhvillojë punimet. • Aktivistët theksojnë se duhet të mblidhen kundër deputetëve dhe qeverisë së korruptuar, ndërsa u kujtojnë qytetarëve që të marrin edhe vezë për t'i qëlluar. • Protestuesit kërkojnë ndryshim të gjithë klasës politike, mesazh të cilën e kanë përcjellë prej 109 ditësh me thirrjen "Rama në burg, Berisha në burg". • Pavarësisht 109 ditëve të protestave, protestuesit deklarojnë se nuk do të tërhiqen dhe se do të vijojnë qëndresën deri në realizimin e kërkesave të tyre. • "Arrestoni Ramën", "O Ergys o legen prite Ramën se po vjen", "Edi Rama frikacak", "Dorëheqje, ju erdhi fundi", "Policia e krimi", "Edi Rama jep dorëheqjen", "Edi Rama në burg", "O Erion o legen prite Ramën se po vjen", "Shqipëria e shqiptarëve, vdekje tradhtarëve", "Pa rini nuk ka Shqipëri", "Poshtë patronazhistët" dhe "Shqipëria kërkon revolucion", janë disa nga thirrjet kryesore që protestuesit kanë brohoritur në kor gjatë tubimit.

[6 artikuj për këtë temë.](#)

47 MINUTA ME PARE

Mbyllet protesta e 109-të, protestuesit: Nesër në dyert e Kuvendit!



TIRANË- Protesta e 109-të kundër qeverisë është mbyllur pas disa orësh marshimi në rrugët e Tiranës, ku qytetarët dhe aktivistët përsëritën thirrjet për largimin e kryeministrit Edi Rama. Tubimi i kësaj të mërkure nisi në sheshin "Skënderbej" dhe vijoi drejt Kryeministrit. Pas fjalimeve të mbajtura para godinës së qeverisë, protestuesit rinisën marshimin në rrugët e kryeqytetit, duke shoqëruar lëvizjen me thirrje dhe slogane kundër qeverisë.

Një pjesë e fjalimeve iu kushtua edhe vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Protestuesit shprehën solidaritetin e tyre dhe gjatë tubimit u dëgjuan edhe thirrjet "UÇK, UÇK". Në fjalimet e protestës, Vatnikaj u bëri thirrje qytetarëve për qëndresë të vazhdueshme në rrugë, ndërsa konfirmoi se revoltës do t'i bashkohet nesër në orën 10:00 bllokimi i Kuvendit të Shqipërisë.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 21:52

Vuçiç i pakënaqur me vendimin e Hagës/ Kritikon reagimet e Ramës dhe Kurtit: Imagjinoni sikur një zyrtar i yni të thoshte 'Liria ka emër'

Në fjalimet e protestës u kërkuar dorëheqja e panegociueshme e kryeministrit Rama, ndërsa aktivistët deklaruan se protesta do të vijojë edhe në ditët në vazhdim. Protesta e sotme shënoi ditën e 109-të të këtij aksioni qytetar në Tiranë./Dosja.al

2 ORE ME PARE


Protesta qytetare në Tiranë/ Nis marshimi i protestuesve në rrugët e Tiranës



Pamje nga marshimi

TIRANË- Protesta qytetare në Tiranë shënon ditën e sotme 109 ditë të revoltës qytetare në Tiranë. Pas mbylljes së fjalimeve përballë godinës së Kryeministrit, protestuesit kanë nisur marshimin në rrugët e Tiranës me thirrjet "Nuk shitet Shqipëria, shitet qeveria".

Gjatë tubimit të sotëm nuk kanë munguar fjalimet në lidhje me vendimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Sakaq, kërkesat e protestuesve mbeten dorëheqja e panegociueshme e kryeministrit Edi Rama, rrëzimi i qeverisë si dhe anulimi i ligjit për zonat e mbrojtura./Dosja.al



3 ORE ME PARE

Gjykata Speciale dënoi katër ish-krerët e UÇK-së, protestuesi: E rëndë për popullin shqiptar



POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 16:18

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 12:46

DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

më të klikuarat

Përgjimet dhe akuzat për tregti armësh, reagon kompania ku u përgjuan: Ron Yeffet nuk na përfaqëson, përgjimi ishte i paautorizuar

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro



Të shtënat me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një avokat, policia në kërkim të autorit (EMRAT+PAMJET)

Tensione para Dhomave të Specializuara në Hagë/ Protestuesit përplasen me policinë holandeze: Largohuni ose do përdorim forcën (VIDEO)

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi



Protestuesi

shqiptar për tu
përshtatur me
tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e
"shkarkoi" sot Edi
Ramen?

Moti

Powered by  tomorrow.

TIRANË- Protesta në Tiranë vijon nismën e saj për 109 ditë radhazi, ndërsa kërkesat e protestuesve mbeten të njejtat. Gjatë tubimit perballë Kryeministrit, një qytetar është ngjitur në podium dhe është shprehur në lidhje me vendimin e Gjykatës së Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Në fjalën e tij ai e ka cilësuar vendimin si të padrejtë dhe e rëndë për popullin shqiptar. Protestuesi përmendi se dikur, kryeministri Rama lobonte që kjo gjykatë të krijohet, ndërkohë që so, ajo vendos kundër luftëtarëve të Kosovës. Vendimi ndaj ish-krerëve, sipas tij, është një moment reflektimi për çdo shqiptarë që të kuptojnë forcën e rezistencës ndaj protestave.

"Ajo që ka ndodhur sot është e rëndë për popullin shqiptar. Është moment i thellë reflektimi për çdo shqiptar dhe duhet të kuptojmë se sa e rëndësishme është rezistenca jonë për të larguar një kryeministër të tillë që në 2015 lobonte që kjo gjykatë të bëhej dhe sot i dënon udhëheqësit e UÇK-së."

A e kuptoni se çfarë bëjnë kryeministrat e korruptuar, që shpirtin ia kanë shitur shejtanit. Këta janë të gatshëm jo vetëm të shesin Shqipërinë, por edhe çdo vepër të lavdishme të këtij kombi për të qëndruar në pushtet.

Ne duam ta kthejmë këtë ditë në forcë dhe nuk duhet të dorëzohemi. Ato ligje që Rama lobonte në 2015 miratoheshin në Kuvendin e Kosovës, janë njësoj si ligjet që ky ka miratuar në Kuvendin e Shqipërisë.", tha ai./Dosja.al

3 ORE ME PARE

Vendimi për ish-krerët e UÇK-së/ Dritan Goxhaj nga protesta: UÇK-ja nuk ishte një grup kriminal, por përgjigje e një populli që po shfarosej



Dritan Goxhaj, ish-luftëtar i UÇK-së

TIRANË- Protesta në Tiranë ka shënuar ditën e 109-të të revoltës qytetare kundër qeverisë. Në protestën e sotme nuk kanë munguar as reagimet nga protestuesit në lidhje me vendimin e Gjykatës së Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Pjesë e protestës ka qënë edhe ish-luftëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Dritan Goxhaj, i cili ka marrë fjalën në podium dhe e ka cilësuar vendimin si të padrejtë dhe të bazuar në dëshmi të rreme, dhe me procedura që nuk kanë asnjë lidhje me të vërtetën.

Ai është shprehur në fjalën e tij se një gjykatë e cila bazohet në dëshmi të manipuluar dhe nuk ka transparencë, nuk ka

kontroll. UÇK-ja, sipas Goxhaj nuk ishte një grup kriminal apo një lëvizje terroriste por ishte përgjigja e një populli që po shfaqej kundër shtetit serb që thoshte "Kosova është Serbi"

Dritan Goxhaj: Sot dua të lexoj një deklaratë në emër të grupit koordinues. Sot, një ditë e zezë për luftën e popullit për liri. Sot, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë dhanë dënime të rënda për katër ish-pjesëtarët e UÇK-së.

Sot, ne nuk po flasim për drejtësi, po flasim për padrejtësi, për një gjykatë që nuk ka asgjë të përbashkët me asnjë gjykatë tjetër në botë. Po flasim për një vendim të bazuar në dëshmi të rreme, mbi procedura të panjohura dhe mbi një axhendë politike që nuk ka asnjë lidhje me të vërtetën.

Ne jemi të qartë, kjo nuk është drejtësi, është teatër. Një gjykatë politike që bazohet mbi dëshmi të rreme, të paprovuara, të manipuluar, që nuk ka juri, nuk ka transparencë, nuk ka kontroll. Një gjykatë politike që dënon njerëz që kanë luftuar për lirinë e popullit të tyre.

Kjo nuk është drejtësi, kjo është padrejtësi e organizuar. Kjo padrejtësi po vjen nga Evropa, e ngritur mbi parimet e të drejtave të njeriut, drejtësisë dhe lirisë. Evropa për të cilën kemi ëndërruar dhe shtrirë dorën për ndihmë, bashkëpunim dhe integritim. Vjen nga Evropa, nga ana që pretendojnë se janë miq tanë.

Kjo padrejtësi po ndodh nga ajo Evropë që në vitin 1913 vendosi të na copëtojë Shqipërinë, Kosovën ia dha Serbisë pa pyetur shqiptarët, pa pyetur askënd, vetëm për të bërë paqe në Ballkan. Stabiliteti nuk mund të përdoret më si pretekst duke sakrifikuar të drejtën e shqiptarëve për të vetëvendosur dhe për të jetuar të lirë.

UÇK-ja nuk ishte një grup kriminal, nuk ishte një ushtri e huaj, nuk ishte një lëvizje terroriste. UÇK-ja ishte përgjigja e një populli që po shfaqej kundër shtetit serb, që vriste në rrugë, digjte shtëpi, përdhunonte gra, dëbonte fëmijë dhe thoshte: "Kosova është Serbi". /Dosja.al

4 ORE ME PARE

Protesta në Tiranë/ Nis marshimi drejt godinës së Kryeministrit



Pamje nga marshimi

TIRANË- Protestuesit e pranishëm në protestën e sotme të organizuar në Tiranë, pas grumbullimit në sheshin Skënderbej kanë nisur marshimin drejt godinës së Kryeministrit.

Ata kanë paralajmëruar për ditën e nesërme një tubim përballë Kuvendit, ku do të mbahen seanca e dytë plenare për sesionin e ri parlamentar. Kërkesat e qytetarëve mbeten të njejta, ata kërkojnë dorëheqjen e panegociueshme të kryeministrit Edi Rama si dhe anulimin e ligjit për zonat e mbrojtura. /Dosja.al

4 ORE ME PARE

Dita e 109-të e protestës/ Nis organizimi i protestuesve në sheshin Skënderbej





Pamje nga protestat në Tiranë

TIRANË- Qytetarët prej 109 ditësh janë mbledhur në qendër të Tiranës për të vijuar protestat kundër klasës politike. Ata e kanë nisur grumbullimin e tyre në sheshin Skënderbej, për të marshuar më tej drejt godinës së Kryeministrit ku do të mbahen fjalime.

Kërkesat e qytetarëve mbeten dorëheqja e panegociueshme e kryeministrit të vendit Edi Rama, si dhe anulimi i ligjit për zonat e mbrojtura./**Dosja.al**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.